# **Art figurativ**

# **Klasa IX**

*Libri i mësuesit/es*

*Libër mësuesi për tekstin shkollor*

Përmbajtja

Hyrja ..... 4
Qëllimet e arsimit parauniversitar ..... 5
Parimet e arsimit parauniversitar ..... 5
Kompetencat kryesore të të nxënit ..... 5
Kurrikula lëndore/ program mësimor ..... 13
Temat mësimore të shpërndara nëpër muaj ..... 19
Plani dymujor ..... 22
Plani i orës mësimore ..... 48

# Hyrja

Lënda e artit figurativ për klasën e nëntë është e rëndësishme për fushën kurrikulare dhe bashkë me lëndët e tjera të fushës ka një rol dhe ndikim të rëndësishëm mbi edukimin e nxënësve, kultivimin e vlerave kulturore, artistike, intelektuale, shpirtërore etj,. Përmes artit zhvillohet personaliteti dhe identiteti personal e kulturor. Arti figurativ zgjeron njohuritë, shkathtësitë, imagjinatën, kreativitetin, mendimin kritik, shprehinë, shijën estetike. Mësimdhënësi ka obligim dhe detyrë që të arrijë rezultate gjatë mësimit të artit figurativ, prandaj për t'ia lehtësuar punën dhe për të përmbushur detyrat dhe rezultatet i kemi ofruar këtë libër të mësimdhënësit. Suksese!

## Qëllimet e arsimit parauniversitar

Të gjitha nivelet formale të arsimit parauniversitar mbështesin nxënësit të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat në harmoni me kërkesat/nevojat e shoqërisë demokratike, duke:

- kultivuar identitetin personal, kombëtar, të përkatësisë shtetërore e kulturore;
- promovuar vlerat e përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvilluar përgjegjësinë ndaj vetvetes, shoqërisë dhe mjedisit;
- aftësuar për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësuar për ndërmarrësi dhe për përdorim/shfrytëzim të teknologjisë;
- aftësuar për mësim gjatë gjithë jetës. Më gjerësisht për qëllimet e arsimit parauniversitar, shih Kornizën kurrikulare.

## Parimet e arsimit parauniversitar

Kurrikula Bërthamë siguron koherencë dhe qëndrueshmëri mes të niveleve formale të arsimit parauniversitar duke u mbështetur në këto parime: Gjithëpërfshirje, që nënkupton ofrimin e mundësisë për përfshirje dhe qasje të barabartë të të gjithë e fëmijëve dhe të rinjve në arsim cilësor. Zhvillim i kompetencave që reflektohet nëpërmjet rezultateve të nxënit, që pritet të arrihen në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme nga të gjithë nxënësit në periudha të ndryshme të shkollimit. Mësimdhënie dhe nxënie të integruar dhe koherente, që promovon të nxënit e plotë, duke reflektuar ndërlidhjet dhe ndërvarësinë e natyrës dhe të botës së krijuar nga njeriu me njohuritë dhe informacionin që ka nxënësi për to. Autonomi dhe fleksibilitet në nivel shkolle, në zbatimin e Kurrikulës Bërthamë dhe pjesës me zgjedhje, që reflektohen në planifikim, organizim dhe realizim të procesit mësimor dhe aktivitete jashtëkurrikulare. Përgjegjësi dhe llogaridhënie, që reflektohen në krijimin e kulturës për vlerësim të vazhdueshëm të progresit në zbatimin e kërkesave të Kurrikulës përmes mbledhjes dhe analizës së të dhënave, dokumentimit të sfidave dhe zgjidhjeve drejt një paraqitjeje më të mirë në përmbushjen e kërkesave të Kurrikulës dhe ngritjes së cilësisë së arsimit. Më gjerësisht për parimet e arsimit parauniversitar, shih Kornizën kurrikulare.

## Kompetencat kryesore të të nxënit

Kompetencat përfshin një sistem të integruar dhe koherent të njohurive shkathtësive dhe i qëndrimeve të aplikueshme dhe të transferueshme, të cilat i dëshmojnë se nxënësit janë aftësuar të ballafaqohen me sfidat e epokës digjitale, të ekonomisë së tregut të lirë dhe të bazuar në dije, në një botë të marrëdhënieve të ndërvarura. Kompetencat burojnë nga qëllimi i përgjithshëm i arsimit parauniversitar, të cilat janë rezultat i të nxënit të njohurive,

shkathtësive, vlerave e qëndrimeve në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme përgjatë niveleve të caktuara të sistemit arsimor. Ato duhet të dëshmojnë se për çka janë të aftë nxënësit pas një periudhe të caktuar të të nxënit. Këto kompetenca janë: 1. Kompetenca komunikimi dhe të shprehurit 2. Kompetenca të menduarit 3. Kompetenca të mësuarit për të nxënë 4. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis 5. Kompetenca personale 6. Kompetenca qytetare. Kompetencat reflektohen nëpërmjet rezultateve të të nxënit, të cilat janë të përgjithshme e të cilat shprehin atë se çfarë duhet të arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme deri në fund të arsimit të detyrueshëm. Kompetencat komunikimi dhe të shprehurit, kompetenca të menduarit dhe kompetencat për të mësuar janë të natyrës instrumentale: ato janë bazë për kompetencat e tjera, të cilat më tepër janë të lidhura me rrethanat dhe me përmbajtjen e caktuar, siç janë kompetencat e nevojshme në jetën private, publike dhe profesionale. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (Komunikues efektiv) Me qëllim që nxënësit dhe të rinjtë të zhvillohen si personalitete, të mësojnë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri, është me rëndësi që t'i kuptojnë porositë që u drejtohen dhe të shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhëve, simboleve, shenjave, kodeve dhe formave artistike. Për të komunikuar në mënyrë efektive, nxënësit përkrahen që të shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur, kritike dhe kreative mjetet dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit. Kompetenca e të menduarit (Mendimtar kreativ/krijues dhe kritik) Përveç aftësisë përtë identifikuar dhe përt'iu qasurinformatës/burimittë njohurisë së caktuar, nxënësit kanë nevojë të zhvillojnë edhe kapacitete përt'iu qasur njohurive dhe përt'i përpunuar dhe gjykuar në mënyrë kritike, kreative dhe ndërvepruese. Kompetenca e të mësuarit (për të nxënë) tërëjetësor (Nxënës i suksesshëm) Për një nxënës të suksesshëm shkolla angazhohet të kultivojë vazhdimisht kërshërinë e nxënësve dhe interesimin për të nxënë si dhe të zhvillojë kompetencat për të mësuar. Shkolla po ashtu duhet të vetëdijesohet për stilet dhe strategjitë efektive mësimore. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis (Kontribues produktiv) Shkolla angazhohet që nxënësi/ja të përgatitet të punojë në mënyrë të pavarur dhe të vetëdijesohet për rolin dhe përgjegjësinë e tij në mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit. Për të zhvilluar këtë kompetencë nxënësi/ja përkrahen që të kuptojë në mënyrë të plotë ndërvarësinë ndërmjet fenomeneve shoqërore dhe natyrore. Njëkohësisht, duke e pasur parasysh arsimin për zhvillim të qëndrueshëm, ai/ajopërgatitet që të ballafaqohen me preokupime mjedisore, ekonomike dhe sociale. Kompetenca personale (Individ i shëndoshë) Shkolla përgatit nxënësit që në mënyrë efektive dhe konstruktive të inkuadrohen në jetën familjare, shoqërore dhe të punës. Në këtë kontekst, nxënësit përkrahen që të vetëdijesohen për veten dhe të kenë vetëbesim, por njëkohësisht të jenë të hapur dhe të kenë besim te të tjerët. Kompetenca qytetare (Qytetar i përgjegjshëm) Shkolla përgatit nxënësin/en për të jetuar së bashku me të tjerët dhe për të tejkaluar sfida kryesore me të cilat ballafaqohet në jetën e përditshme. Kjo kompetencë siguron që nxënësi të jetë në gjendje të veprojë si qytetar i përgjegjshëm, duke marrë parasysh kontekstin e ngushtë dhe të gjerë të zhvillimeve në shoqëri. 3.1. Rezultatet e të nxënit të kompetencave kryesore për shkallë Kompetencat krysore të kurrikulës zbërthehen në rezultate të të nxënit për shkallë. Ato janë pjesë e Kurrikulave bërthamë dhe parashihet të arrihen nga të gjithë nxënësit me rastin e përfundimit të një shkalle kurrikulare. Rezultatet e të nxënit nuk mbulojnë gjithçka që nxënësit kanë mësuar apo është dashur të mësojnë gjatë një shkalle të caktuar. Ato shprehin kërkesat esenciale të arritjes kompetencave kryesore me rastin e përfundimit të një shkalle të caktuar si dhe promovojnë integrim të mëtejmë të fushave të kurrikulës në funksion të zhvillimit të kompetencave kryesore të përcaktuara me Kornizën kurrikulare. Secila fushë e kurrikulës, si një tërësi e organizimit të procesit mësimor, ndihmon zhvillimin dhe arritjen e kompetencave kryesore nga nxënësit. Po ashtu edhe çështjet (temat) ndërkurrikulare dhe jashtëkurrikulare (veprimtaritë jashtëkurrikulare) luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe arritjen e kompetencave kryesore, përkatësisht ndihmojnë nxënësit në arritjen rezultateve të kompetencave për shkallë kurrikulare. Rezultati i të nxënit përkufizohet si: "Deklaratë që përshkruan atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë një nxënës/se në fund të një shkalle apo niveli". Ai shpreh një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë,

qëndrimet dhe vlerat. Rezultatet e të nxënit për kompetenca në nivel shkalle artikulojnë pritjet e mësimdhënësve, të autoriteteve arsimore, të prindërve dhe të shoqërisë në raport me arritjet konkrete, të matshme, të nxënësve në fund të çdo shkalle të kurrikulës. Ato (REN) janë bazament për hartimin e programeve mësimore, organizimit mësimor në shkollë, hartimit të teksteve shkollore dhe të materialeve të tjera mësimore.

| **Nr.** | **Rezultatet e të nxënit për shkallën 4 dhe kompetencat kryesore** |
|---|---|
| **I** | **Kompetenca komunikim dhe të shprehurit- Komunikues efektiv** |
| 1. | Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit. |
| 2. | Përshkruan një ngjarje, të dhënë si detyrë, të lexuar ose të dëgjuar më parë, në formë verbale, vizuale ose me shkrim, duke ruajtur rrjedhën logjike të saj. |
| 3. | Diskuton për një temë të caktuar në gjuhën amtare, në gjuhën angleze ose në gjuhën e dytë të huaj në lëndë të ndryshme, duke respektuar rregullat e pjesëmarrjes efektive për këmbimin e informatave dhe të ideve. |
| 4. | Harton një tekst, deri në pesëqind fjalë, duke e vazhduar një rrëfim gojor apo tekst të lexuar paraprakisht duke u bazuar në imagjinatën e vet. |
| 5. | Prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërshetuar format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik. |
| 6. | Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore. |
| 7. | Identifikon burime të ndryshme të informacionit për arsimim, orientimin profesional dhe harton një plan individual për zhvillimin e karrierës në fushën e komunikimit (gazetar etj.). |
| 8. | Inicion biseda shoqërore me moshatarët dhe me të rriturit për tema me interes mësimor/shoqëror, duke shtruar pyetje për temën dhe duke u përgjigjur dhe veçuar informatën kryesore. |
| II. | Kompetenca të menduarit-- Mendimtar kreativ dhe kritik |

| | |
|---|---|
| 1. | Paraqet, në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për të sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara. |
| 2. | Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre. |
| 3. | Analizon një punim artistik ose joartistik (p.sh., artikull gazetaresk, pikturë... etj.) duke gjetur analogji dhe dallime me punime të ngjashme nga autorë të ndryshëm. |
| 4. | Përpunon idenë e vet në një projekt me shkrim për një çështje të caktuar duke propozuar aktivitetet kryesore, përcakton qëllimin kryesor, afatet, vendin, personat, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e atyre aktiviteteve si dhe parasheh pengesat e mundshme gjatë realizimit të tyre. |
| 5. | Arsyeton ndërmarrjen e hapave konkretë, të cilët kanë rezultuar përfundimin e një detyre/aktiviteti, zgjidhjen e një problemi apo të ndonjë punimi në klasë/shkollë apo gjetiu. |
| 6. | Demonstron zgjidhjen e një problemi (matematik, linguistik ... etj.) bazuar në të dhënat tekstuale ose tekstuale numerike, eksperimentale të detyrës e cila bëhet në klasë/shkollë apo jashtë saj duke arsyetuar me gojë zbatimin e ecurive përkatëse për arritjen e rezultatit. |
| 7. | Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme. |
| 8. | Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive. |

| **III** | **Kompetenca të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm** |
|---|---|
| 1. | Regjistron në formë të shkruar, grafike, me TI etj., informatat ose faktet për një temë të caktuar duke i veçuar, me anë të teknikave të ndryshme, pjesët e rëndësishme dhe më pak të rëndësishme të nevojshme për atë temë/detyrë të dhënë. |

| | |
|---|---|
| 2. | Shfrytëzon në mënyrë efikase fjalorët, enciklopeditë dhe teknologjinë informative apo burimet e tjera gjatë ndërtimit të një ideje ose projekti me bazë klase/shkolle ose jashtë saj. |
| 3. | Regjistron në skeda dhe teknika të tjera të veçanta, TI etj., informatat ose faktet a formulat për një temë të caktuar duke i radhitur ato sipas llojit, burimit dhe rëndësisë mësimore të tyre. |
| 4. | I parashtron pyetje vetes për çështjet që trajton dhe organizon mendimet për të gjetur përgjigje për temën apo problemin e caktuar duke regjistruar përparimin apo ngecjen derisa të gjejë zgjidhjen përfundimtare. |
| 5. | Paraqet/skicon idetë e veta për ecurinë dhe mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti duke e sqaruar dhe duke argumentuar më pas këtë para të tjerëve. |
| 6. | Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj. |
| 7. | Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të papaqarta. |
| 8. | Zbaton elementet e dosjes personale për identifikimin e anëve të veta të forta, i shfrytëzon ato për orientim në profesionin e ardhshëm si dhe për vetëvlerësimin e përparimit, qoftë përmirësimin apo ngecjen në fusha të ndryshme mësimore. |

| **IV** | **Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis-Kontribuues produktiv** |
|---|---|
| 1. | Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme. |
| 2. | Ndërmerr aktivitete të ndryshme (ekspozitë, performancë, instalacion, fushatë, protestë paqësore, tubim, avokim etj.) në bazë të projektit, të hartuar me anëtarët e grupit, për zgjidhjen e një problemi me rëndësi shoqërore, për shkollën ose për komunitetin. |

| | |
|---|---|
| 3. | Analizon pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe të biodiversitetit, paraqet në formë të shkruar, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit, mendimin dhe qëndrimin e vet për këtë çështje, por edhe organizon ndonjë aktivitet për mbrojtjen e mjedisit. |
| 4. | Përdor programet kompjuterike për përpunimin e të dhënave dhe paraqitjen e vizatimeve/diagrameve të nevojshme për përgatitjen e materialeve individuale apo/ dhe publikimeve të ndryshme të shkollës. |
| 5. | Zhvillon një plan për shpenzimet dhe kursimet mujore personale, të familjes ose të klasës, arsyeton pastaj rëndësinë e krijimit të shprehisë për të planifikuar. |
| 6. | Përdor materiale, burime të ndryshme informimi dhe teknologjinë në shkollë dhe në jetën e përditshme si ndihmë për përparimin në mësime dhe për orientim në karrierë. |
| 7. | Propozon kriteret për vlerësim të paanshëm të një aktiviteti sportiv, shkencor, teknologjik, artistik etj., si anëtar jurie të ngritur në nivel klase, shkolle apo shoqërie civile. |
| 8. | Hulumton nevojat e shkollës ose të komunitetit (me anë të fotografive, videoprojektimit të të dhënave nga terreni) dhe në bazë të tyre organizon aksione vullnetare dhe humanitare për plotësimin ose përmirësimin e atyre nevojave. |
| V | Kompetenca personale -- Individ i shëndoshë |
| 1. | Vlerëson përmbajtjen dhe vlerat ushqyese të llojeve të ushqimeve të cilat njeriu i konsumon, duke i kategorizuar ato në bazë të nevojave të individit për to në situata të ndryshme, si: gjatë stinëve, sëmundjeve etj. |
| 2. | Argumenton nevojën e respektimit të regjimit për ushqyerje të shëndetshme dhe rekreacion ditor, javor apo mujor, sipas udhëzimeve të lexuara ose të dëgjuara nga mjeku gjatë një diskutimi në klasë, në shkollë apo në familje. |
| 3. | Vlerëson domosdoshmërinë e kushteve të mira higjienike për përgatitjen dhe konsumimin e ushqimeve dhe pijeve dhe shpjegon rrethanat e mundshme të helmimit nga ushqimet dhe papastërtia. |

| | |
|---|---|
| 4. | Zhvillon aktivitete fizike dhe sportive me karakter rekreativ apo garues, duke bërë përpjekje për arritjen e standardeve të caktuara, me angazhim dhe sjellje të pëlqyera, por edhe duke menaxhuar emocionet e veta gjatë paraqitjes së rezultateve. |
| 5. | Analizon shkaqet e një reagimi konfliktuoz apo emocional nxënës-nxënës dhe propozon alternativa për zgjidhje të drejtë e pa pasoja, duke ndarë përvojat, mendimet dhe ndjenjat me anëtarët e grupit. |
| 6. | Dallon atributet e mirësjelljes nga ato përçmuese ndaj të tjerëve gjatë punës në grup ose në situata emocionale dhe propozon masat për parandalimin/kapërcimin e tyre. |
| 7. | U shpjegon moshatarëve, me forma dhe mjete të ndryshme të komunikimit, rëndësinë e identifikimit të personave dhe shërbimeve kompetentë, veç e veç, të nevojshme për mbështetje në situata që konsiderohen potencialisht të rrezikshme për shëndetin fizik dhe mendor. |
| 8. | Përshkruan mundësitë, rreziqet dhe pasojat e infeksioneve dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe sqaron mënyrat dhe mjetet për parandalimin e tyre, duke përdorur forma të ndryshme të prezantimit (të folur, të shkruar, grafike, pllakate, pamflete, lojë teatrale, performancë artistike etj.). |
| 9. | Reagon ndaj sjelljeve asociale të moshatarëve duke identifikuar shkaqet e shfaqjes dhe pasojat e mundshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit nga dukuritë dhe shprehitë negative (p.sh., përdorimi i duhanit, i alkoolit apo drogës) etj. |
| VI | Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm |
| 1. | Praktikon të drejtat dhe detyrimet e qytetarisë në situata konkrete jetësore të përditshme, qoftë në klasë, qoftë në shkollë apo gjetiu (si: gjatë diskutimit, respektimit të mendimit të tjetrit etj.). |
| 2. | Reagon, nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit, ndaj personave të cilët në ndonjë mënyrë shkelin, cenojnë ose mohojnë të drejtat e të tjerëve, duke ilustruar me shembujt e figurave të shquara historike, personazheve nga letërsia a filmat si dhe arsyeton pasojat e këtyre veprimeve për individin, grupin dhe komunitetin. |

| | |
|---|---|
| 3. | Shpreh solidaritet me personat në nevojë ose të rrezikuar, duke ndërmarrë veprime/aksione konkrete për ofrimin e ndihmës sipas nevojës që kanë. |
| 4. | Merr pjesë në përgatitjen dhe organizimin e një votimi të zhvilluar në klasë ose në shkollë për një aktivitet të caktuar duke zbatuar rregullat përkatëse dhe raporton më pas me shkrim për rrjedhën e gjithë procesit. |
| 5. | Reagon me maturi ndaj sjelljeve apo veprimeve jo të mira që ndodhin në klasë/shkollë apo jashtë saj, promovon sjelljet dhe veprimet e mira duke vënë në pah shkaqet dhe pasojat e manifestimit të tyre për individin dhe për të tjerët. |
| 6. | Identifikon paragjykimet apo dukuritë jo të mira në klasë, në shkollë apo në komunitet, merr qëndrim ndaj tyre duke propozuar veprime konkrete për luftimin e tyre. |
| 7. | Përgatit një aktivitet me bashkëpjesëmarrje me të tjerët, duke përdorur tolerancën si mjet për promovimin e diversitetit kulturor, etnik, gjinor, fetar, social etj., në shkollë apo në komunitet. |
| 8. | Përshkruan, në forma të ndryshme të të shprehurit, procedurat dhe institucionet përgjegjëse për hartimin dhe ndryshimin e ligjeve duke argumentuar domosdoshmërinë e zbatimit të tyre në jetën e përditshme. |
| 9 | Prezanton pa ngurrim të kaluarën e familjes, të rrethit shoqëror ose të personaliteteve dhe ngjarjeve kryesore të kombit të vet, për të krahasuar të tashmen me të kaluarën dhe për të nxjerrë përfundime për të ardhmen. |

Kurrikula lëndore/ program mësimor

## Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësit në klasën e nëntë arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Artet, të shkallës së katërt të kurrikulës (Shk 4) në Kurrikulën Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë:

| Koncepti | Tema | Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL) |
|---|---|---|
| **Krijimtaria dhe performanca artistike** | **Krijimi i punimeve artistike**<br><br>*(Vizatimi, Piktura, Grafika, Skulptura, Artet aplikative, Dizajni, Multimedia, Postproduksioni,, Fotografia artistike, Arkitektura, Arti publik, video art, instalacioni, performanca, land art, body art etj.)* | *Nxënësi:*<br>• *Realizon punime në mediume të ndryshme artistike*<br>• *Dallon drejtimet dhe mediumet e ndryshme artistike*<br>• *Realizon llojet e ndryshme të vizatimit bashkëkohor;*<br>• *eksperimenton dhe aplikon teknika të ndryshme të vizatimit;*<br>• *realizon punime në mediumin e pikturës duke përdorur teknika bashkëkohore e të kombinuara të pikturës;*<br>• *eksperimenton dhe shprehet me anë të përdorimit dhe kombinimit të ngjyrave të ndryshme;*<br>• *Gdhend shabllone për të shtypur imazhe grafike;*<br>• *Realizon skulptura tredimensionale në teknika dhe materiale të ndryshme;*<br>• *Dallon skulpturën bashkëkohore dhe postmoderne;*<br>• *Realizon skulptura dydimensionale në formë relievi;*<br>• *Identifikon skulptorët më të njohur bashkëkohor;*<br>• *Realizon fotografi artistike duke përdorur aparate të ndryshme teknologjike;* |

| | | |
|---|---|---|
| | | • *Identifikon fotografët më të njohur*<br>• *Përpunon imazhet me anë të programeve të ndryshme kompjuterike duke realizuar postproduksionin;*<br>• *Dallon format e*<br>• *artit publik dhe realizon vepra në ambiente publike;*<br>• *Dallon mediumet e ndryshme të artit aplikativ;*<br>• *Realizon punime të ndryshme në dizajn grafik dhe multimedia;*<br>• *Dizajnon enteriere dhe eksteriere bashkëkohore;*<br>• *Identifikon dizajnerët më të njohur*<br>• *Realizon maketa të objekteve të arkitekturës bashkëkohore;*<br>• *Identifikon arkitektët më të njohur të arkitekturës bashkëkohore;*<br>• *Dallon dhe realizon punime në mediumet e artit bashkëkohor;*<br>• *Identifikon artistët më të njohur të mediumeve bashkëkohore të instalacionit, videoartit, performancës;*<br>• *Përdor videoartin si medium artistik për të paraqitur idetë e tij;*<br>• *Realizon instalacione të ndryshme artistike;*<br>• *Dallon dhe krijon vepra të ndryshme artistike në mediumin e performancës;*<br>• *Dallon dhe eksperimenton me artin e tokës dhe të trupit* |

| | | |
|---|---|---|
| **Gjuha dhe komuniki mi artistik** | **Elementet figurative**<br><br>*(Vija, forma, ngjyra, tonaliteti, vëllimi, tekstura, hapësira, madhësia, zëri, lëvizja etj)*<br><br>**Parimet e artit**<br><br>*(Baraspesha, harmonia, kompozimi, gradacioni, bashkësia, proporcionet, sipërfaqja, ritmi, kontrasti)* | *Nxënësi:*<br>• *Përdor elementet figurative në realizimin e punimeve artistike;*<br>• *Dallon dhe analizon elementet figurative në vepra të artistëve të njohur;*<br>• *Përdor parimet e artit në realizimin e veprave artistike;*<br>• *Dallon dhe vlerëson parimet e artit në veprat e artistëve të njohur;*<br>• *Dallon dhe përdor lloje të ndryshme të vijave në punimet artistike;*<br>• *Dallon format dy dhe tri dimensionale në punime skulpturale;*<br>• *Dallon ndarjen e ngjyrave primare, sekondare, terciare, plotësuese, analoge, të ftohta dhe të ngrohta;*<br>• *përdor nuanca të ngjyrave në punimet artistike;*<br>• *përdor tonalitetin duke krijuar idenë e vëllimit në vepra pikturale;*<br>• *realizon tekstura artistike duke përdorur forma dhe materiale të ndryshme;*<br>• *dallon dhe aplikon llojet e hapësirave të ndryshme;*<br>• *përdor planet hapësinore për të krijuar iluzionin e hapësirës;*<br>• *dallon rëndësinë dhe format e ndryshme të kompozicionit;*<br>• *dallon dhe aplikon baraspeshën simetrike dhe asimetrike në punimet artistike;*<br>• *Dallon dhe aplikon llojet e ndryshme të harmonive në një vepër arti;* |

| | | |
|---|---|---|
| | | • *Respekton parimin e proporcionalitetit gjatë realizimit të imazheve reale;*<br>• *Përdor sipërfaqe të ndryshme në një kompozicion;*<br>• *Dallon dhe përdor llojet e ndryshme të ritmit në punimet artistike;*<br>• *Realizon punime duke përdorur parimin e kontrastit.* |
| **Relacioni art – shoqëri** | **Aktivitete kulturore - artistike** | *Nxënësi:*<br>• *Merr pjesë në ekspozita shkollore dhe jashtëshkollore;*<br>• *Merr pjesë në projekte të ndryshme artistike brenda dhe jashtë shkollës;*<br>• *Ndjek aktivitete të ndryshme artistike si ligjërata, prezantime, takime me artistë, kurator, estet, filozof të artit;*<br>• *Ndjek seminare dhe ngjarje të tjera të artit;*<br>• *Merr pjesë në konkurse të ndryshme artistike etj.* |
| | **Ngjarje artistike**<br><br>**Institucionet e artit** | *Nxënësi:*<br>• *Dallon dhe ndjek ngjarje artistike të njohura brenda dhe jashtë vendit;*<br>• *Ndjek ekspozitat e njohura kombëtare dhe ndërkombëtare (bienale, festivale etj.);*<br>• *Viziton atelje dhe studio të artistëve;*<br>• *Viziton galeri arti të njohura brenda dhe jashtë vendit;*<br>• *Viziton muze arti kombëtar dhe ndërkombëtar;*<br>• *Viziton institucione të ndryshme të artit, qendra kulturore,*<br>• *Realizon vizita virtuale në internet të institucioneve të artit, muze galeri në faqe të ndryshme etj* |

| | | |
|---|---|---|
| | **Drejtimet, rrymat dhe zhanret e artit**<br><br>**Vepra arti**<br><br>**Artistët e njohur**<br><br>**Periudhat historike të artit**<br><br>*Ekspresionizmi*<br>*Abstrakt*<br>*Arti Informal*<br>*Op Arti*<br>*Pop Arti*<br>*Arti kinetik*<br>*Ngjarjet*<br>*Minimalizmi*<br>*Arti Konceptual*<br>*Instalacioni*<br>*Video arti*<br>*Fluxus*<br>*Performanca*<br>*Arti i trupit*<br>*Postminimalizmi*<br>*Hiperealizmi*<br>*Arte Povera*<br>*Arti i tokës*<br>*Neoekspresionizmi*<br>*Artistët e Rinj Britanik* | *Nxënësi:*<br>• *Kupton zhvillimet historike të artit dhe dallon periudha të ndryshme të artit;*<br>• *përshkruan dhe dallon karakteristikat kryesore të periudhave historike të artit;*<br>• *Identifikon karakteristikat dalluese të veprave të njohura të artit në periudha të ndryshme historike;*<br>• *Debaton rreth periudhave të artit dhe veprave artistike duke përdorur një fjalor të pasur artistik;*<br>• *Identifikon përfaqësuesit kryesor të periudhave dhe drejtimeve të ndryshme artistike;*<br>• *Identifikon dhe dallon kryeveprat artistike të artistëve të njohur;*<br>• *Shqyrton rëndësinë e artit përgjatë zhvillimeve të ndryshme historike për shoqërinë;*<br>• *analizon veprat e artit në kontekstin e tyre historik duke i lidhur me ngjarjet e rëndësishme shoqërore e sociale;*<br>• *Identifikon zhvillimet e ndryshme shkencore, teknologjike, sociale që ndikuan në zhvillimin e artit;*<br>• *Përshkruan dhe vlerëson vepra arti dhe objekte të trashëgimisë kulturore të trojeve shqiptare;*<br>• *Identifikon dhe analizon simbolet në vepra të artit për të lexuar kuptimin e tyre;*<br>• *Identifikon dhe analizon elementet dhe parimet e gjuhës pamore dhe teknikën e përdorur në vepra të artit.* |

| | | |
|---|---|---|
| | *Arti bashkëkohor shqiptar* | |
| **Çmuarja dhe vlerësimi estetiko-artistik** | **Vlerësimi i Periudhave dhe drejtimeve të artit**<br><br>**Vlerësimi i Veprave artistike** | *Nxënësi:*<br>• *Reflekton mendimin dhe gjykimin e tij mbi një vepër arti, përmes formave të ndryshme të të shprehurit si përmes shkrimit (esesë), poezisë etj.;*<br>• *Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke përshkruar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike;*<br>• *Kultivon aftësinë e shijimit dhe përjetimit të veprave artistike dhe rafinon shijen e tij estetike në art;*<br>• *Zhvillon aftësinë se si të lexojmë një vepër arti;*<br>• *Dallon metodat dhe hapat që ndjekin kritikët për të vlerësuar veprat e artit;*<br>• *Dallon objektin e studimit të estetikës dhe cilësitë estetike në një vepër arti;*<br>• *Krijon kulturën debatuese për diskutimin dhe trajtimin e çështjeve dhe problemeve të artit;* |

Temat mësimore të shpërndara nëpër muaj

| TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE | | | |
|---|---|---|---|
| **Tematika** | **Shpërndarja e përmbajtjes së lëndës** | | |
| Lëndët e fushës kurrikulare | Shtator-Dhjetor<br><br>(15 orë) | Janar- Mars<br><br>(12 orë) | Prill- Qershor<br><br>(8 orë) |
| Krijimi i punimeve artistike | | Vizatimi | |
| | | Piktura | |
| | | Skulptura | |
| | | Artet aplikative | |
| | | Dizajni | |
| | | Fotografia artistike | |
| | | Arkitektura | |
| | | Arti public | |
| | | Video art | |
| | | Instalacioni | |
| | | Përformanca | |
| | | Land art | |
| | | Body art | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Gjuha dhe komunikimi | Vija | | |
| | Forma | | |
| | Ngjyra | | |
| | Tonaliteti | | |
| | Vëllimi | | |
| | Tekstura | | |
| | Hapsira | | |
| | Madhësia | | |
| | Lëvizja | | |
| | Ritmi | | |
| | Baraspesha | | |
| | Gradacioni | | |
| | Kompozicioni | | |
| | Kontrasti | | |
| Relacioni art - shoqeri | | | Ekspresionizmi Abstrakt |
| | | | Pop Arti |
| | | | Arti Konceptual |
| | | | Instalacioni |
| | | | Video Arti |
| | | | Performanca |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | Arti i Trupit |
| | | | Arti Pover |
| | | | Arti i T<br>okës |
| | | | Arti bashkohor shqiptar |
| Çmuarja dhe vlerësimi estetiko-artistik | | | **Vlerësimi i periudhave dhe drejtimeve të artit** |
| | | | **Vlerësimi i veprave artistike** |

Plani dymujor

| Lënda-ët e fushës kurrikulare | TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE | | | | Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 4 (Klasa IX ). | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | PERIUDHA (I) | | PERIUDHA (II) | PERIUDHA (III) | | |
| | SHTATOR-TETOR | NËNTOR-DHJETOR | JANAR - SHKURT - MARS | PRILL- MAJ- QERSHOR | I | Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv<br>1,2,5,8 |
| Lënda: | **Elementet figurative**<br><br>(Vija, forma, ngjyra, tonaliteti, vëllimi, tekstura, hapësira, madhësia, zëri, lëvizja etj) | **Parimet e artit**<br><br>(Baraspesha, harmonia, kompozimi, gradacioni, bashkësia, proporcionet, sipërfaqja, ritmi, kontrasti) | **Krijimi i punimeve artistike**<br><br>(Vizatimi, Piktura, Grafika, Skulptura, Artet aplikative, Dizajni, Multimedia, Postproduksioni,, Fotografia artistike, Arkitektura, Arti publik, video art, instalacioni, performanca, land art, body art etj.)<br><br>**Aktivitete kulturore artistike** | **Ngjarje artistike**<br><br>**Institucionet e artit**<br><br>**Drejtimet, rrymat dhe zhanret e artit**<br><br>**Vepra arti**<br><br>**Artistët e njohur**<br><br>**Periudhat historike të artit**<br>Ekspresionizmi Abstrakt<br>Arti Informal<br>Op Arti<br>Pop Arti<br>Arti kinetik<br>Ngjarjet | II<br><br>III<br><br>IV<br><br>V<br><br>VI | Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ<br>1,3,5<br><br>Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm<br>2,5,6<br><br>Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv<br>1,2,3,4,7,8<br><br>Kompetenca personale – Individ i shëndoshë<br>5,6,9<br><br>Kompetenca qytetare – Qytetar i |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Minimalizmi<br>Arti Konceptual<br>Instalacioni<br>Video arti<br>Fluxus<br>Performanca<br>Arti i trupit<br>Postminimalizmi<br>Hiperealizmi<br>Arte Povera<br>Arti i tokës<br>Neoekspresionizmi<br>Artistët e Rinj Britanik<br>Arti bashkëkohor shqiptar<br>**Vlerësimi i periudhave dhe drejtimeve të artit**<br><br>**Vlerësimi i veprave artistike** | | **përgjegjshëm**<br>**3,7,9** |
| | | | | | | |

**SHTATOR- TETOR**

| **TEMA-T mësimore:** | **Elementet figurative** *(Vija, forma, ngjyra, tonaliteti, vëllimi, tekstura, hapësira, madhësia, zëri, lëvizja etj)* |
|---|---|

**RNK- Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

**Kompetenca komunikim dhe të shprehurit- Komunikues efektiv**

1. Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.

5. Prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërshetuar format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik.

6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore. 8. Inicion biseda shoqërore me moshatarët dhe me të rriturit për tema me interes mësimor/shoqëror, duke shtruar pyetje për temën dhe duke u përgjigjur dhe veçuar informatën kryesore.

**II. Kompetenca të menduarit-- Mendimtar kreativ dhe kritik**

1. Paraqet, në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për të sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara.

3. Analizon një punim artistik ose joartistik (p.sh., artikull gazetaresk, pikturë... etj.) duke gjetur analogji dhe dallime me punime të ngjashme nga autorë të ndryshëm

5. Arsyeton ndërmarrjen e hapave konkretë, të cilët kanë rezultuar përfundimin e një detyre/aktiviteti, zgjidhjen e një problemi apo të ndonjë punimi në klasë/shkollë apo gjetiu

**III. Kompetenca të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm**

2. Shfrytëzon në mënyrë efikase fjalorët, enciklopeditë dhe teknologjinë informative apo burimet e tjera gjatë ndërtimit të një ideje ose projekti me bazë klase/shkolle ose jashtë saj

5. Paraqet/skicon idetë e veta për ecurinë dhe mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti duke e sqaruar dhe duke argumentuar më pas këtë para të tjerëve.

6. Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj.

**IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis-Kontribuues produktiv**

1. Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.

2. Ndërmerr aktivitete të ndryshme (ekspozitë, performancë, instalacion, fushatë, protestë paqësore, tubim, avokim etj.) në bazë të projektit, të hartuar me anëtarët e grupit, për zgjidhjen e një problemi me rëndësi shoqërore, për shkollën ose për komunitetin.

3. Analizon pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe të biodiversitetit, paraqet në formë të shkruar, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit, mendimin dhe qëndrimin e vet për këtë çështje, por edhe organizon ndonjë aktivitet për mbrojtjen e mjedisit.

4. Përdor programet kompjuterike për përpunimin e të dhënave dhe paraqitjen e vizatimeve/diagrameve të nevojshme për përgatitjen e materialeve individuale apo/ dhe publikimeve të ndryshme të shkollës.

7. Propozon kriteret për vlerësim të paanshëm të një aktiviteti sportiv, shkencor, teknologjik, artistik etj., si anëtar jurie të ngritur në nivel klase, shkolle apo shoqërie civile.

8. Hulumton nevojat e shkollës ose të komunitetit (me anë të fotografive, videoprojektimit të të dhënave nga terreni) dhe në bazë të tyre organizon aksione vullnetare dhe humanitare për plotësimin ose përmirësimin e atyre nevojave.

**V. Kompetenca personale -Individ i shëndoshë**

5. Analizon shkaqet e një reagimi konfliktuoz apo emocional nxënës-nxënës dhe propozon alternativa për zgjidhje të drejtë e pa pasoja, duke ndarë përvojat, mendimet dhe ndjenjat me anëtarët e grupit.

6. Dallon atributet e mirësjelljes nga ato përçmuese ndaj të tjerëve gjatë punës në grup ose në situata emocionale dhe propozon masat për parandalimin/kapërcimin e tyre

9. Reagon ndaj sjelljeve asociale të moshatarëve duke identifikuar shkaqet e shfaqjes dhe pasojat e mundshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit nga dukuritë dhe shprehitë negative (p.sh., përdorimi i duhanit, i alkoolit apo drogës) etj.

**VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm**

3. Shpreh solidaritet me personat në nevojë ose të rrezikuar, duke ndërmarrë veprime/aksione konkrete për ofrimin e ndihmës sipas nevojës që kanë.

7. Përgatit një aktivitet me bashkëpjesëmarrje me të tjerët, duke përdorur tolerancën si mjet për promovimin e diversitetit kulturor, etnik, gjinor, fetar, social etj., në shkollë apo në komunitet.

9. Prezanton pa ngurrim të kaluarën e familjes, të rrethit shoqëror ose të personaliteteve dhe ngjarjeve kryesore të kombit

**RNF- Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

II. 1. Përdorin në mënyrë efektive njohuritë e tyre mbi elementet, proceset dhe teknikat interpretuese dhe krijuese artistike duke i përdorur ato në mënyrë të vetëdijshme në krijimet e tyre vetjake.
II.2. Komunikojnë me vetëbesim dhe siguri para audiencave të ndryshme, duke kombinuar format dhe mjetet shprehëse të arteve edhe me ndihmën e teknologjisë (prezantime multimediale, instalacione etj.).
II.3. Dallojnë aplikimet e inovacioneve në teknika shprehëse dhe mediume bashkëkohore të artit (si video arti, Instalacioni, Performanca etj.), në veprat e artit bashkëkohor.
II.4. Komunikojnë me vetëbesim dhe siguri me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale) për audienca të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë të tjerë, publik më i gjerë etj.).
II.5. Analizojnë dhe krahasojnë traditat e ndryshme artistike në periudha te ndryshme historike

| **Tema-t mësimore** | **Rezultatet e të nxënit për tema mësimore RNL** | **Njësitë mësimore** | **Koha e ...** | **Metodologjia e mësimdhënies** | **Metodologjia e vlerësimit** | Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare | **Burimet** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
